



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

**Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike / Odbor Kosovske Akademije za Javnu
Bezbednost / Board of Kosovo Academy for Public Safety**

Nr. 1/29

Datë: 20.09.2019

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-053 për Akademijnë e Kosovës për Siguri Publike si dhe në bazë të nenit 4 dhe nenit 11 të Rregullores Nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në mbledhjen e mbajtur më 20 shtator 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkriptit nga mbledhja e 28-të e Bordit të AKSP-së të mbajtur me datë 10.07.2019.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Nehat Thaqi

Kryesues i Bordit

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Bordit, dhe
- Arkivit të AKSP-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

**Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike / Odbor Kosovske Akademije za Javnu
Bezbednost / Board of Kosovo Academy for Public Safety**

Nr. 2-29

Datë: 20.09.2019

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike si dhe në bazë të nenit 4 dhe nenit 11 të Rregullores Nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në mbledhjen e mbajtur më 20 shtator 2019, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Caktohet mënyra e vijimit të pjesës teorike dhe praktike për zyrtarët e institucioneve të sigurisë publike që vijojnë studimet në programin bachelor në sigurinë publike në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike si në vijim:
 - 1.1. Pjesa teorike (ligjëratat) vijohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike gjatë tri (3) ditëve siç janë: e enjte prej orës 17:00, ndërsa te premtën dhe te shtunën gjatë ditës.
 - 1.2. Dita e premte sipas pikës 1.1. llogaritet ditë pune e liruar nga institucionet e sigurisë publike për vijimin e ligjëratave.
 - 1.3. Pjesa praktike (internshipi) vijohet gjatë periudhës pas përfundimit të ligjëratave e më së largu deri më 30 shtator të çdo viti përkatës akademik në vendet e caktuara të punës në institucionet përkatëse bazuar në plan programit mësimor, intershipi mbahet gjatë orarit të punës.
2. Fakulteti i sigurisë Publike / AKSP administron orarin e mësimit për studentët e Fakultetit sipas pikës 1.1. të këtij vendimi.
3. Obligohet Akademia e Kosovës për Siguri Publike dhe institucionet e sigurisë publike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi nr. 2-7 të datës 18.06.2014.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Nehat Thaqi
Kryesues i Bordit

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Bordit
- AKSP, FSP, PK, DK, AME, SHKK, SHSK, IPK;
- Arkivit të AKSP-së.